

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Viti i kalit, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së dhe 193 fjalime
ADRESA	https://www.gazetatema.net/blogu-tema/viti-i-kalit-asambleja-e-pergjithshme-e-okb-se-dhe-193-fjalime-i588947
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	28 shtator 2026, 12:33:37 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	28 shtator 2026, 13:10:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	dec242ed86f8b2ca0867db65cea923d6cb7f8202aa41679e89f2758ae862fdcb
TEKSTI	6193389054d866b982d47366c1e9cf56b85e5a1bcd665a8f85dec2983af27aee
PAMJA	c326fe41d5f24e380ee157503ffc993c390cf91a15d1c43b4629a420fc05d5b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	dc7ce510d7d9009b1a8b46a0d30a2acf535d1c502cc01ea1e07ee51e544b7127
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c9da2c073e2a83be1965121fd231137d695108173d39514ad5452b64d4c51b05
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/dc7ce510d7d9009b1a8b46a0d30a2acf535d1c502cc01ea1e07ee51e544b7127>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)
- [Hosteni](#)

 English

Built and Monetized by 

 English

1 e [Stacioni i trenit ne Rinas - Shpallet htuesi per projektimin dhe ndertimin. I hapet rruga lidhjes se kontratesAktorja 50-vjeçare shfaqet ne superforme nga Maldivet. pozat fundit](#)

Viti i kalit, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së dhe 193 fjalime



28 Shtator 2026, 15:10Blog Nga Enver Robelli

Kush i dëgjon 193 fjalime? Korrespondenti i një gazete gjermane në New York ia bëri vetes këtë pyetje dhe vendosi të ulej në një karrige të parehatshme prej plastike dhe të dëgjonte, të dëgjonte, të dëgjonte... Rezultati? Një fjalim historik i kryetarit të Mongolisë. Dhe një përgjigje në pyetjen se përse Republika Nauru tani quhet Naoero.

Edhe sivjet krerët e botës u mbledhën në New York, në selinë e OKB-së, ku u mbajt Asambleja e Përgjithshme vjetore. Atmosfera i ngjan pak Kapali Çarshisë së Stambollit, pak pazarit Khan al-Khalil në Kajro dhe më shumë një kampionati botëror të diplomacisë. Një javë, 193 fjalime nga të 193 shtetet anëtare. Shto këtu edhe fjalimet e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Presidentit të Asamblesë së Përgjithshme, përfaqësueses së BE-së, Selisë së Shenjtë, si dhe Palestinës, e cila ka statusin e vendit vëzhgues.

Kush i dëgjon 193 fjalime? Korrespondenti i “Süddeutsche Zeitung” në New York ia bëri vetes këtë pyetje dhe vendosi të ulej në një karrige të parehatshme prej plastike dhe të dëgjonte, të dëgjonte, të dëgjonte... Rezultati i kësaj sfide është një reportazh mjaft interesant (i botuar të hënën). Kur flet Donald Trumpi, shumica e dëgjojnë, rrinë në sallë. Është burrë i rëndësishëm. Edhe kur flet kinezi është me rëndësi. Edhe ky është burrë me ndikim. Për arsye të ditura është e rëndësishme se çfarë thotë kryetari i Ukrainës. Por e vërteta e hidhur është: shumica e presidentëve dhe kryeministrave flasin para karrigeve të zbrazëta. Nuk i ndodhi kjo vetëm kryeministrit të Shqipërisë. Në fjalimin e tij, presidenti i Finlandës Alexander Stubb citoi diplomatin veteran amerikan Strobe Talbott: “Multilateralizmi është një ferr i vërtetë dhe mund të të acarojë nervat. Nga ana tjetër, ky mbetet prapëseprapë opsioni më i mirë që kemi si njerëzim”. (Më 1999 Talbott ka qenë diplomati kryesor amerikan që negocioi me Rusinë mbi praninë e KFOR-it në Kosovë; rusët dëshironin një sektor më vete, nuk e morën).

Ka dëgjuar kush për Ukhaaagiin Khürelsükh? Ky është presidenti i Mongolisë. “Süddeutsche Zeitung” shkruan se në fjalimin e tij para Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, Khürelsükh citoi nga një letër që sundimtari mongol Oljeitu i shkroi mbretit francez Filipit të Bukur në vitin 1305: “Me të vërtetë, nuk mund të ketë asgjë më të mirë se pajtimi e mirëkuptimi”. Trashëgimtarët e Xhingis Hanit besonin se njerëz me kultura të ndryshme mund të bashkëjetonin paqësisht, në vend që t’i çanin kokën njëri-tjetrit pa pushim. Kjo përvojë e largët historike e shtyu presidentin mongol Khürelsükh të pyeste nëse kjo “Pax Mongolica” nuk do të ishte një model i mirë për një të tashme më paqësore, për një “Pax Globalica”. Presidenti Khürelsükh i merr punët me nge. Në odën e madhe të OKB-së ai shpalli “kandidaturën zyrtare” të Mongolisë për anëtare jo të përhershme të Këshillit të Sigurimit të OKB-së – për vitet 2048 dhe 2049. Kësaj i thonë planifikim afatgjatë.

Sipas korrespondentit të gazetës gjermane, presidenti mongolëz tërhoqi vëmendjen edhe me një detaj tjetër. Ai lavdëroi rezolutën 79/291 të OKB-së, me anë të së cilës u shpall “Dita Botërore e Kalit”, për të vlerësuar – sipas Khürelsükhit – “kontributin e paçmueshëm të kuajve” në historinë e njerëzimit. Në korrik, kjo ditë botërore u kremtua për disa ditë me radhë në Ulan Bator, me një paradë prej rreth 10’000 kuajsh e kalorësish, si dhe me të ftuar nga 56 vende.

David Adeang kishte një hall tjetër: ai tha para Asamblesë së OKB-së se si president ka një kërkesë që vendi i tij të mos quhet më Nauru, por Naoero. Pse? Sepse bota e ka keqkuptuar shqiptimin. Mos harroni: Naoero, jo Nauru.

Dhe kështu shkon java, fjalim pas fjalimi. Sonte gjithçka merr fund. Deri në Asamblenë e ardhshme të OKB-së.

Për pak harruam. Edhe presidenti i Zvicrës Guy Parmelin foli në New York. Zvicra ka refuzuar të jetë anëtare e OKB-së deri në vitin 2002. Parmelin, me profesion prodhues vere, e nisi fjalimin me metafora alpine. Ia vlen të lexohet së paku fillimi:

“Të nderuara zonja dhe të nderuar zotërinj, Zvicra është një vend malesh, luginash dhe larmie gjuhësore. Në vazhden e historisë sonë, ne kemi mësuar ta kapërcejmë atë që na ndan. Ne nuk i rrafshuam malet. Ne mësuam të ngjitemi në to. Dhe më vonë, t’i çajmë mespërmes. Për këtë qëllim ndërnuam rrugë, ura dhe tunele. E kuptuam qartë se një kufi natyror nuk duhet të jetë medeoemos një vijë ndarëse – ai mund të shndërrohet edhe në një vend takimi. Kjo përvojë e thjeshtë më duket e zbatueshme edhe për botën tonë të sotme”.

Sikur të ishte aq lehtë...

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Media italiane: Rasti Veliaj, drejtësia shqiptare nën lupë: rasti që vë në vështirësi Melonin](#)

13:00 Blog / 5 komente

Rasti "Hyseni" na çon në të njëjtën krizë të përjetshme

10:15 Blog

Sondazhi AIM: Kur ka qenë më problematik SHISH/SHIK?

10:05 Blog

E PLOTË/ Mesazhi i Ramës pas akuzave të SPAK për zyrtarët pranë tij: Korrupsioni po goditet, nuk po rritet! Shqipëria nuk kthehet pas, askush dhe asgjë nuk do të më ndalë

16:00 Blog / 30 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.